



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 47 prot.

Tiranë, më 08.01.2026

Lënda: Mendim mbi një projektligj

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 5259/2 prot., datë 05.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3180 prot., datë 11.12.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital” (në vijim “projektligji”), si dhe relacionin shoqërues.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së projektligjit, konstatohet se në tërësi është hartuar në përputhje me parashikimet e legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Megjithatë, vlerësojmë që gjatë finalizimit të projektligjit të merren në konsideratë shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme.

Neni 6 i projektligjit, vërejmë se i referohet rasteve të përdorimit të “pseudonimit” gjatë transaksioneve elektronike, ndër të tjerë, edhe për subjektet e të dhënave apo individët.

Nga shqyrtimi i kuadrit rregullator me të cilin synohet përafrimi, si dhe pikës 5, të nenit 9 të projektligjit, i cili referon pajtueshmërinë në raport me parashikimet e ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji nr. 124/2024”), sugjerojmë që, **në nenin 3 të projektligjit**, të shtohet një pikë ku të specifikohet përkufizimi i pseudonimit.

Gjithashtu, me qëllim që të evidentohen personat (të cilëve gjatë zbatimit të projektligjit në fjalë, do t’u përpunohen të dhënat personale), nga personat fizikë e juridikë (për identifikimin e të cilëve do të përpunohen të dhëna tregtare), sugjerojmë që, po në këtë nen, **të shtohet përkufizimi i subjektit të të dhënave**, sipas pikës 23, të nenit 5 të Ligjit nr.124/2024, me përmbajtje: “*“Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik i identifikuar*

ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror”.

Më tej, **referuar pikës 6, të nenit 7 dhe nenit 12 të projektligjit**, parashikohet ndërveprimi i Portofolave të Identitetit Digjital me mjete ekzistuese kombëtare të identifikimit elektronik.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, ndërveprimi i Portofolit të Identitetit Digjital me baza të tjera të të dhënave, me qëllim identifikimin elektronik të përdoruesve, legjitimohet vetëm nëse është e parashikuar në legjislacionin specifik, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit nr.124/2024.

Duke marrë në konsideratë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që në projektligj, duhet të identifikohen në mënyrë konkrete, mjete ekzistuese kombëtare të identifikimit elektronik, si dhe kategoritë e të dhënave personale që do të shkëmbehen nga ndërveprimi dhe do të përpunohen për përmbushjen e detyrimeve ligjore duke u bazuar në parashikimet e legjislacioneve respektive nga autoritetet/institucionet përgjegjëse. Këto përcaktime duhet të realizohen në harmoni me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin dhe parimin e minimizimit të të dhënave, të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 6 të Ligjit nr.124/2024, sipas të cilave të dhënat personale mblidhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, si dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit.

Në kuptim të Ligjit nr.124/2024, subjektet e të dhënave në cilësinë e përdoruesve, gëzojnë të drejtën për transferueshmërinë e të dhënave. Për këtë arsye, si dhe në mënyrë që të unifkohet terminologjia e përdorur me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që, në **shkronjën “e”, të pikës 3, të nenit 7 të projektligjit**, fjala “*bartje*” të zëvendësohet me fjalën “*transferueshmëri*”.

Ndërkohë, në **shkronjën “a/x” të pikës 4, të nenit 7 të projektligjit**, sugjerojmë që togfjalëshi “*të dhëna të paligjshme ose të dyshimta*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*për përpunim të paligjshëm të të dhënave personale*”.

Në vijim, bazuar në nenin 23 të Ligjit nr.124/2024, sugjerojmë që, pas **pikës 11, të nenit 7 të projektligjit**, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “*Portofolat garantojnë sigurinë e përpunimit të të dhënave personale duke integruar mbrojtjen e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Bazuar në parimin e integritetit dhe konfidencialitetit, i parashikuar në pikën 6, të nenit 6 dhe nenin 28 të Ligjit nr.124/2024, të dhënat personale, nga ana e kontrolluesve dhe përpunuesve, duhet të përpunohen në mënyrë të tillë që të garantohet në zbatim siguria e nevojshme e të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm dhe humbja, shkatërrimi ose dëmtimi aksidental, nëpërmjet përdorimit të masave të duhura teknike dhe organizative.

Për këtë arsye, sugjerojmë që, në fjalinë e **pikës 13, të nenit 7 të projektligjit**: *“Të dhënat personale në lidhje me ofrimin e Portofolit do të mbahen logjikisht të ndara nga çdo e dhënë tjetër e mbajtur nga ofruesi i Portofolit”,* fjala *“logjikisht”* të hiqet.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, shkronja “b”, e pikës 15, e nenit 7 të projektligjit, krijon paqartësi. Për këtë arsye, ju sjellim në vëmendje se, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, konkretisht në nenin 7 të Ligjit nr.124/2024, parashikohen në mënyrë eksplicite kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale, si dhe rastet kur legjitimohet përpunimi i tyre pa pëlqimin paraprak të subjekteve të të dhënave.

Për këtë qëllim, sugjerojmë që, **shkronja “b”, e pikës 15, e nenit 7 të projektligjit**, të riformulohet, në mënyrë të qartë, të kuptueshme, si dhe konform kërkesave ligjore për përpunimin e të dhënave personale, sipas neneve 6, 7 dhe 8 të Ligjit nr.124/2024.

Pika 20, e nenit 7 të projektligjit i referohet aksesit dhe përdorimit të Portofolave, nga personat me aftësi të kufizuar. Në kuptim të Ligjit nr.124/2024, për identifikimin e personave me aftësi të kufizuar, nevojitet përpunimi i të dhënave sensitive, konkretisht të dhënave që tregojnë informacionin në lidhje me gjendjen e tyre shëndetësore.

Lidhur me sa më sipër, përpunimi i të dhënave sensitive lejohet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 9 të Ligjit nr.124/2024, ndaj sugjerojmë që **pika 20, e nenit 7 të projektligjit**, të riformulohet me përmbajtje: *“Portofolat bëhen të aksesueshëm për përdorim, nga personat me aftësi të kufizuara, njëjloj me përdoruesit e tjerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Në vijim të argumentimit ligjor sa më sipër, sugjerojmë që, edhe **në fjalinë e parë të nenit 25 të projektligjit**, pas togfjalëshit *“në përputhje me”*, të shtohet togfjalëshi *“legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që në të gjithë projektligjin, termi *“privatësi”* të zëvendësohet me togfjalëshin *“mbrojtje e të dhënave personale”*. Ndaj, sugjerojmë që, **shkronja “c”, e pikës 3, e nenit 20 të projektligjit** të formulohet me përmbajtje: *“c) lehtëson zbatimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurisë që në projektim”*.

Ndërkohë, duke marrë në konsideratë ndikimin e rëndësishëm që këto shërbime do të kenë mbi qytetarët, si dhe me qëllim garantimin e sigurisë dhe transparencës rekomandohet kryerja e Vlerësimit të Ndikimit mbi Mbrojtjen e të Dhënave për procesin e identifikimit elektronik, shërbimet e besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital. Ky detyrim vjen si një domosdoshmëri, për shkak të natyrës, objektit, qëllimit dhe shkallës së gjerë të përpunimit të të dhënave gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve si një standard evropian i përcaktuar në Rregulloren e BE-së 2016/679 (GDPR), por edhe në përputhje me nenin 31 të Ligjit nr.124/2024.

Në përfundim, edhe pse ky detyrim, në zbatim të pikës 2, të nenit 101 të Ligjit nr.124/2024, hyn në fuqi në shkurt të vitit 2027, vlerësojmë që marrja në konsideratë e tij që në fazën e projektimit të shërbimeve kontribuon në parandalimin e rreziqeve që mund të cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave, forcon besimin e publikut, si dhe rrit përgjegjshmërinë e palëve të përfshira në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Sa më sipër, me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi